



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

Nr. 2081 prot.

Ersekë më 30.03.2026

PROJEKT VENDIM

NR. _____ DATË. _____.2026

“MBI PROPOZIMIN E SHITJES SE LENDES DRUSORE QE REZULTOI NGA KRIJIMI KORIDORIT PYJOR SI MASE PARANDALUESE NGA ZJARRET NE PYJE SIPAS ANALIZES SE KOSTOS”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nën pikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, Shkonjat “a” ,“b” dhe “c”, nenit 27, pika 5, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pika 4 dhe 6, nenit 64 shkronja “a” dhe “c”, të Ligjit nr.139/2015 datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433 datë, 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, të ndryshuar, pikës 5 shkronja “ç”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 “ Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ishkomunave/bashkive”, VKM nr. 267, datë 27.4.2023 “për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 559, datë 29.7.2022, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” si dhe VKB-Kolonjë nr.94 datë 29.08.2025”Për miratimin e ndryshimit të pikës 4 të VKB-së nr.36 datë 13.03.2025 të zërave të shpenzimeve të Buxhetit për Fondin e Kushtëzuar të mbrojtjes civile”

1. Të miratojë dhënie e dakordësisë për propozimin e shitjes se lendes drusore qe rezultoi nga krijimi korridorit pyjor si mase parandaluese nga zjarret ne pyje me cmim fillestar 4051 lek/m³ pa TVSH sipas Analizes së Kosos.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Pyjeve , Parqeve dhe Rekreacionit dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Konceptoi :Ing.F.Kasko

Pranoi :P.Kristo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
NËN/KRYETAR
Petro RISTO

KRYETARI

Erion ISAI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

Nr. 2051 prot.

Ersekë më 30.03.2026

RELACION
“MBI PROPOZIMIN E SHITJES SE LENDES DRUSORE QE REZULTOI NGA
KRIJIMI KORIDORIT PYJOR SI MASE PARANDALUESE NGA ZJARRET NE PYJE
SIPAS ANALIZES SE KOSTOS”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënparagrafi 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, Shkonjat “a” , “b” , dhe “c”, nenit 27, pika 5, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pika 4 dhe 6, nenit 64 shkronja “a” dhe “c”, të Ligjit nr.139/2015 datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433 datë, 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, të ndryshuar, pikës 5 shkronja “ç”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 “ Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ishkomunave/bashkive” VKM nr. 267, datë 27.4.2023 “për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 559, datë 29.7.2022, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, si dhe VKB-Kolonjë nr.94 datë 29.08.2025” Për miratimin e ndryshimit të pikës 4 të VKB-së nr.36 datë 13.03.2025 të zërave të shpenzimeve të Buxhetit për Fondin e Kushtëzuar të mbrojtjes civile”

Të miratojë dhënie dhe dakordësi për propozimin e shitjes se lendes drusore qe rezultoi nga krijimi koridorrit pyjor si mase parandaluese nga zjarret ne pyje me cmim fillestar 4051 lek/m³ pa TVSH sipas Analizes së Kostos:

Bazuar në Kontratën Prokurimi ,Shërbime Nr.19 datë 03.12.2025 me objekt “Shërbim prerje për krijimin e korridorit pyjor për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve” rezultoi një material drusor lloji Pishë e zezë në sasinë totale 125 m³, të cilat janë marrë në dorëzim sipas procesverbal kolaudimit të ngastrës 138a Ekonomia Pyjore Leskovik data 23.12.2025 dhe procesverbalit për marrjen në dorëzim të lëndës drusore. sasi që do të përdoren për nevoja emergjente, ura ,pasarella etj.

Duke patur këtë gjëndje materiali drusor, mendojme që sasia lëndë drusore lloji Pishë e cila gjendet në

skele nga shërbimi prerje për krijimin e korridorit pyjor për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve, të shitet në një kohë sa më të afërt sepse ky material gjendet jashtë(terren) dhe i ekspozuar nga kushtet atmosferike,lënia aty bën që lënda ti nënshtrohet procesit të kalbëzimit dhe kështutë zhvlersohet nga ana cilësore .

Pas diskutimit nga anëtarët prezentë propozojmë të :

1. Miratojë dhënien e dakordesise për propozimin e shitjes se lendes drusore qe rezultoi nga krijimi korridorit pyjor si mase parandaluese nga zjarret ne pyje *me cmim fillestar 4051 lek/m³ pa TVSH sipas Analizes së Kosos.*
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Pyjeve , Parqeve dhe Rekreacionit dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore", tëndryshuar.

Konceptoi :Ing. F.Kasko
Pranoi :P.KRISTO




**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
NËN/KRYETAR
Petro RISTO**

KRYETARI

Erion ISAI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

Nr. 1950 Prot.,

Ersekë, më 24/03/2026

Lënda: Miratim i relacionit për procedurën e ankandit me objekt:
“Propozim për shitjen e lëndës drusore që rezultoi nga krijimi i korridorit pyjor si masë parandaluese nga zjarret në pyje Bashkisë Kolonjë”

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM
Znj. Sofika REXHEPI

Për dijëni: Personit përgjegjës për prokurimin
Znj. Anxhela KRISTO

Bazuar në relacionin e Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit Nr. 1821 Prot., datë 17.03.2026 për “Propozimin për shitjen e lëndës drusore që rezultoi nga krijimi i korridorit pyjor si masë parandaluese nga zjarret në pyje” si dhe kontratën e prokurimit Nr. 19, datë 03.12.2025 me objekt “Shërbim prerje për krijimin e korridorit pyjor për mbrojtjen nga zjarret në pyje”,

Për sa më sipër, miratoj fillimin e procedurës së ankandit me objekt: “Shitjen e lëndës drusore që rezultoi nga krijimi i korridorit pyjor si masë parandaluese nga zjarret në pyje

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR /OSE
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
KRYETARI

ERION ISAI

**Erlon
Isai**

Digitally signed by Erlon Isai
Date: 2026.03.24 15:27:54
+02'00'



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KOLONJË

DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

Nr 1951/Prot

Ersekë më 30.3 . 2026

Lënda : Analize kostoje e prodhimit lëndë drusore lloji pishë (prerje, asortim, pastrim, grumbullim, transport i brendshëm, pastrim, depozitim-stivim) me objekt 'Shitjen e lëndës drusore lloji pishë (trupa) që rezultoi nga krijimi koridorit pyjor parcela 138 a, Ekonomia Pyjore Leskovik

Mbështetur në vendimin e Këshillit Bashkiak Kolonjë nr.94 datë 29.08.2025 , projektin për masat mbrojtëse nga zjarret si dhe Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm Bashkia Kolonjë nr.1951 prot, nr.131, date 24.03.2026 hartojmë preventivin për prodhimin e lëndës drusore lloji pishë (prerje, asortim, pastrim, grumbullim, transport i brendshëm, pastrim, depozitim-stivim) me objekt 'Shitjen e lëndës drusore lloji pishë (trupa) që rezultoi nga krijimi koridorit pyjor në objektin Hija e Radanjit ,Ekonomia Pyjore Leskovik , parcela nr.138 a, lloji pishë e zeze , emërtimi punimeve :

- Procesi, prerje e lende drusore , asortim ,pastrim e llojit pishë e zeze sipas VKM – së 559 Cmimi për m³ 2250 lek
- Grumbullim dhe ngarkim me krahe 375 lek/ m³.
- Transport me krah 536 lek/m³.
- Ngarkim shkarkim me krah në automjet 100 lek/m³
- Transport deri tek sheshi depo.ane te rruges 510 lek/m³
- Pastrim parcele 280 lek/m³.

Totali 4051 lek/m³ pa TVSH.

Kostoja për prodhimin e lëndës drusore lloji pishë (prerje, asortim, pastrim, grumbullim, transport i brendshëm, pastrim, depozitim-stivim) me objekt 'Shitjen e lëndës drusore lloji pishë (trupa) që rezultoi nga krijimi koridorit pyjor parcela 138 a, Ekonomia Pyjore Leskovik , tabela:

RELACION

Mbi lenden drusore lloji pishë që rezultoi nga hapja e koridorit pyjor

Si rezultat i krijimit të koridorit pyjor si masë parandaluese e zjarreve në pyje në parcelën pyjore 138a në objektin Hija e Radanjit, Ekonomia Pyjore Leskovik rezultoi sasia totale prej 125 m³ lende drusore lloji pishë e zeze, bazuar në projektin e miratuar më mbrojtëse nga zjarret, në vendimin e Këshillit Bashkiak Kolonje nr.94 datë 29.08.2025 mbi këtë projekt

- Objekti : Shitje lëndës drusore lloji pishë që rezultoi nga krijimi koridorit pyjor parcela 138 a, Ekonomia Pyjore Leskovik.
- Sasia totale e lendes drusore lloji pishë të prodhuar nga hapja e koridorit pyjor : **125 m³**.
- Vendi lendes drusore lloji pishë : Rrugë pyjore, pranë parcelës 138a, Ekonomia Pyjore Leskovik me emërtimin popullor Hija e Radanjit.
- Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes : Drejtoria e Pyjeve Parqeve dhe Rekreacionit Bashkia Kolonje do të shesë lenden drusore lloji pishë e zeze që rezultoi nga krijimi koridorit pyjor si masë parandaluese e zjarreve në pyje, mendohet që vlefëta fillestare të jetë jo më e vogël se **506 375 lek pa tvsh** ose **607 650 lek me tvsh** për sasinë e prodhuar 125 m³.

Përgjegjësi Drejtorise Pyjeve Parqeve dhe Rekreacionit

Ing. Edrion Ajazi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

Nr. 1821 prot.

Ersekëmë 17 / 03 /2026

RELACION

“Mbi propozimin për shitjen e lendes drusore që rezultoi nga krijimi korridorit pyjor si mase parandaluese nga zjarret në pyje”

**KRYETARIT TË BASHKISË KOLONJË
Z.ERION ISAI**

Përdjeni DREJTORISË SË FINANCËS

Bazuar në Kontratën Prokurimi ,Shërbime Nr.19 datë 03.12.2025 me objekt “Shërbim prerje për krijimin e korridorit pyjor për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve” rezultoi një material drusor lloji Pishë e zezë në sasinë totale 125 m³, të cilat janë marrë në dorëzim sipas procesverbal kolaudimit të ngastrës 138a Ekonomia Pyjore Leskovik data 23.12.2025 dhe procesverbalit për marrjen në dorëzim të lëndës drusore.

Bashkia Kolonjë nga kontrata nr.8 date 09.09.2025 ka gjëndje 8 m³ lëndë ndërtimi dhe 42 m³ janë për të ardhur, gjithsej 50 m³ lëndë ndërtimi ,sasi që do tëpërdoren për nevojaemergjente, ura ,pasarela etj.

Duke patur këtë gjëndje materiali drusor, mendojme që sasia lëndë drusore lloji Pishë e cila gjendet në skele nga shërbimi prerje për krijimin e korridorit pyjor për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve,të shitet në një kohë sa më të afërt sepse ky material gjendet jashtë(terren) dhe i ekspozuar nga kushtet atmosferike,lënia aty bën që lënda ti nënshtrohet procesit të kalbëzimit dhe kështutë zhvlersohet nga ana cilësore .

Për Drejtorinë e Pyjeve Parqeve dhe Rekreacionit

Petro KRISTO
Edrion AJAZI
Fatjon KASKO
Ervin ÇUKA
Islam LIÇO